



AKTI I THEMELIMIT

TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"A³ FURNITURE" shpk.

Sot, më datë 16/07/20024 , para meje Notere ALMA XH. XHURA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.3, QEMAL STAFA, u paraqit personalisht:

THEMELUES/IT:

Klajdi Dervishi, atësia Kasterjot, amësia Suzana, shtetas Shqiptar, lindur në Selckë, Tepelenë dhe banues në TIRANË, me adresë Hamdi Cenojmeri; Nd. 40; H. 1; Njësia Administrative Nr. 6; Njësia Bashkiake Nr. 6; 1027; Tirana, lindur më 20/03/1995, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 039052095 dhe nr. personal J50320005C , .

*me cilesine e "Ortakut Themelues", redaktoj kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklaroj se me vullnet të lire të plete e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", ne ligjin me Nr. 131-2015 PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT ,ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqerine tregtare, me perqegjesi të kufizuar, me emertimin **"A³ FURNITURE" shpk.**,*

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"A³ FURNITURE" shpk.**,

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **"A³ FURNITURE" shpk.**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perqegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personi fizik i siperpermendor, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.

Shoqeria **"A³ FURNITURE" shpk.**, eshte një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku I vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar

Neni 3

Selia

Fq. 1



A2024053280235323768

Shoqeria e ka seline ne Linze, Tirane ne njesin me nr.pasurie 505/59-N2, ZK 2460.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, me vendim te Ortakur te Vetem te shoqerise.

Neni 4

Objekti

Prodhimin dhe tregetimin e materialeve, drusore, alumini, plastik ,import, eksport me pakice dhe shumice te mobiljeve sipas legjisacionit shqiptar.Shitje me shumice dhe pakice te mobiljeve.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II, KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100 000 lekë (njeqind mijë)** dhe eshte i perbere nga **1 kuote**.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga ortaku i vetem i shoqërise perkatesisht :

Klajdi Dervishi, zoterues i 1 kuote, me vlore te **pergjithshme 100 000 Leke (njeqind mijë)**, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakut te vetem mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjera, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit

Fq. 2



A2024053280235323768

të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit , sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Ortaku i vetem për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votimin e tij.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një administrator.

Fq. 3



A2024053280235323768

Administrator i shoqerise eshte Klajdi Dervishi, i cili do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperterite.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset përmes mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisti dhe nënshkruej bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrës Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të veçantë përmes veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmë qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar,

Administratori ka të drejte të krye të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat përmes të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Fq. 4



A2024053280235323768

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemlare me permajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem themelues te shoqerise tregtare "A³ FURNITURE shpk", i cili deklroi se ka lexuar e kuptuar gjithcka ne lidhje me kete statut dhe e nenshkruan irregullisht ate ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të ciles vertetohet nga Noteri.

Ngarkohet Klajdi Dervishi , per depozitim te ketyre akteve prane QKB.

ORTAKU I VETEM

Klajdi Dervishi

NOTE R

ALMA XH. XHURA

Fq. 5